

# PERIODIKU BANKAR

VËSHTRIM MBI SEKTORIN  
FINANCIAR TË KOSOVËS

## NIVELI I KREDIVE JO-PERFORMUESE

# PERIODIKU BANKAR



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

 Banka Ekonomike

 **BKT**  
BANKA KOMBETARE TREGTARE

 **BPB**

 **iSBANK**

 **NLB Banka**

 **ProCredit Bank**

 **Raiffeisen  
BANK**

 **TEB**  
BNP PARIBAS JOINT VENTURE

 **ZiraatBank**

**PËRGATITUR NGA:**

**DR. SC. PETRIT BALIJA,**  
Kryeredaktor

**KRESHNIK KOSUMI,**  
Redaktor

**MIRANDA RUGOVAJ**  
Koordinatore

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

DATA E PUBLIKIMIT,  
Prill 2016



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

**Deklarimi i përgjegjësisë:** Mendimet dhe opinionet e paraqitura në këtë publikim janë përmbledhje e diskutimeve nga panelet e Panairit Financiar 2015. Këto mendime dhe opinione nuk paraqesin domosdoshmërisht qëndrimet e Shoqatës së Bankave të Kosovës. Kjo përmbledhje do të shërbej për reflektim mbi atë se çfarë është konkluduar nga diskutimet dy ditore në Konferencë dhe në hapje të Panairit Financiar 2015 në mënyrë që institucionet relevante të mund të ndërmarrin masat respektive për të përmirësuar mjedisin afarist në Kosovë.

## NIVELI I KREDIVE JO-PERFORMUESE

### PËRMBAJTJA

#### PJESA I

Niveli i kredive jo-performuese 1

Niveli i kredive jo-performuese në Kosovë dhe provizionimi i tyre 2-3

Niveli i kredive jo-performuese në vendet e ballkanit perëndimor 3

#### PJESA II

Indikatorët kryesorë të industrisë bankare 5

Struktura e aseteve 5-6

Struktura e detyrimeve 6-8

Të hyrat dhe shpenzimet 8-10

Norma efektive e interesit në kredi dhe depozita 10-11

#### PJESA III

Lajme nga industria bankare 11- 16

# I.

## NIVELI I KREDIVE JO-PERFORMUESE

---

**K**osova si një ekonomi e re e krijuar nga viti 1999 ka shënuar në vazhdimësi rritje të numrave në kuadër të sistemit financiar. Në këtë rrafsh edhe industria bankare vazhdimisht është rritur, me ç'rast në fund të vitit 2015 kishte arritur vlerën e asetëve në 3,387.3 miliardë euro. Në këtë kuptim, industria bankare shënoj rritje si në vlerën e gjithsej asetëve, po ashtu shënoj rritje në vlerën e depozitave, kredive, transaksioneve, performancës ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve, duke ofruar kështu siguri, stabilitet dhe qëndrueshmëri, faktorë të cilët janë shumë të rëndësishëm në ngritjen e besueshmërisë të klientëve/qytetarëve të Republikës së Kosovës tek industria bankare.



Përveç rritjes së portfolios kreditorë, një faktor tjetër i rëndësishëm është edhe kualiteti i kësaj portofolio, përkatësisht se si janë duke përfomuar kreditë të cilat lëshohen nga industria bankare. Kjo mund të tregohet edhe nga niveli i kredive jo-performuese në nivel të industrisë.

Pasojat në industrinë bankare si rezultat i kredive jo-performuese mund të jenë të mëdha, në rast se nuk ndërmerren hapa parandaluese. Kreditë jo-performuese ndikojnë negativisht në performancën dhe stabilitetin e industrisë bankare, duke rritur provizionimin, tkurrë kreditimin dhe në raste më të rënda mund të sjellë një institucion financiar në gjendje insolvente.

Bankat gjatë gjithë procesit të kreditimit dhe deri në fazën e maturimit të saj përballen me rrezikun nëse klienti ka potencialin për t'a kthyer kredinë brenda afatit apo kushteve të përcaktuara në kontratë. Në rast se klienti nuk arrinë që të kthejë atë kredi brenda afatit të përcaktuar në kontratë, atëherë themi se ajo kredi është problematike dhe nëse ky problem nuk zgjidhet brenda afatit prej 90 dite, atëherë kjo kredi konsiderohet si jo-performuese.

## Niveli i kredive jo-performuese në Kosovë dhe provizionimi i tyre

Industria bankare në Kosovë edhe në aspekt të menaxhimit të cilësisë së portofolios kreditore ka qenë shumë e kujdesshme duke bërë kështu normat e këtyre kredive të jenë shumë të ulëta, çka ka bërë që besimi tek ky sektor të jetë edhe më i lartë.

Për të parë këtë zhvillim, figura 1 tregon përqindjen e kredive jo-performuese dhe përqindjen e rritjes/zvogëlimit të kredive jo-performuese në raport me përqindjen e rritjes së gjithsej portofolios kreditore.




Fig. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (mars 2016), raporti vjetor 2014 dhe raporti i informatave mujore (dhjetor 2015)



Në fund të vitit 2015 përqindja e kredive jo-performuese shënoj vlerat prej 6.2%, çka paraqet një zvogëlim të kësaj përqindjeje prej 18.9% në raport me vitin 2014. Këtë zvogëlim e bën edhe më të rëndësishëm, përqindja e rritjes së portofolios kreditore prej 7.3%, që nënkupton se pavarësisht rritjes së portofolios kreditore, përqindja e kredive jo-performuese është zvogëluar. Nga viti 2012 dhe deri me 2015 përqindja e kredive jo-performuese ka shënuar ulje, siç mund të shihet edhe nga trendi i paraqitur në figurën 1.

KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2015)						
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Vlera e kredive jo-performuese	86.1	96.8	132.3	157.1	154.4	125.2
Provizionet për humbje nga kreditë	115.0%	116.7%	112.7%	110.5%	114.4%	115.1%

Tab. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (mars 2016), raporti vjetor 2014 dhe raporti i informatave mujore (dhjetor 2015)

Në tabelën 1 është e paraqitur vlera në euro e kredive jo-peformuese në raport me përqindjen e provizionimit që industria bankare i ka ndarë për humbjet nga kreditë. Një nga masat parandaluese që bankat i ndërmarrin për t'u mbrojtur nga rreziku kreditor, përkatësisht nga kreditë jo-performuese është provizionimi i kredive të lëshuara. Tabela 1, tregon se në fund të vitit 2015 bankat kanë ndarë provizione deri në 115.1% për të mbuluar humbjet e mundshme nga kreditë jo-performuese. Kjo nënkupton se bankat janë në gjendje të mbulojnë shpenzimet që mund të vijnë nga humbjet si rezultat i kredive jo-performuese.

## Niveli i kredive jo-performuese në vendet e ballkanit perëndimor

Kosova në krahasim me vendet e rajonit ka normat e përqindjeve më të ulëta të kredive jo-performuese, përfshirë këtu Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Serbinë etj. Kosova sipas të dhënave të bankës botërore në fund të vitit 2015 regjistron përqindjen e kredive jo-performuese prej 7.1% në raport me totalin e kredive që industria bankare ka lëshuar për klientët e saj. Ky nivel më i ulët në krahasim me të gjitha vendet e tjera të paraqitura për bazë krahasimi, tregon për kualitetin e lartë të portofolios kreditorë që industria bankare në Kosovë ka tek klientët e tyre.

KREDITË JO-PERFORMUESE NË RAPORT ME GJITHSEJ KREDITË (2010-2015)						
Shteti	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	14.0%	18.8%	22.5%	23.5%	22.8%	20.9%
Bosnja dhe Hercegovina	11.4%	11.8%	13.5%	15.1%	14.0%	14.1%
Kroacia	11.1%	12.3%	13.8%	15.4%	16.7%	17.1%
Kosova	5.8%	5.7%	7.4%	8.5%	8.3%	7.1%
Maqedonia	9.0%	9.5%	10.1%	10.9%	10.8%	11.0%
Mali i Zi	21.0%	15.5%	17.6%	18.4%	16.8%	16.7%
Serbia	16.9%	20.0%	18.6%	21.4%	21.5%	22.8%

Tab. 2 | Burimi: Banka Botërore – Kreditë bankare jo-performuese në raport me bruto totalin e kredive (mars 2016)

Nga vendet e rajonit, Serbia ka regjistruar vlerën më të lartë të kredive jo-performuese me 22.8%, përderisa Shqipëria ka regjistruar 20.9% nga bruto totalin e kredive në fund të vitit 2015. Pas këtyre dy shteteve, radhiten Kroacia me 17.1%, Mali i Zi me 16.7% dhe kështu me radhë.

Nga të gjitha shtetet e paraqitura, Kosova është i vetmi vend në rajon i cili ka arritur të mbajë përqindjen e kredive jo-performuese në numra njëshifror, madje këtë përqindje në fund të vitit 2015 ka arritur që ta zvogëlojë edhe më shumë nëse krahasohet me dy vitet paraprake.






Fig. 2 | Burimi: Banka Botërore – Kreditë bankare joperformuese në raport me bruto totalin e kredive (mars 2016)

Në figurën 2 janë të paraqitura trendet e lëvizjeve të përqindjeve të kredive jo-performuese të vendeve me të cilat kufizohet Kosova. Trendi i kredive jo-performuese të industrisë bankare në Kosovë është dukshëm më i vogël se sa i vendeve me të cilat kufizohet Kosova.

## II. INDIKATORËT KRYESORË TË INDUSTRIËSË BANKARE

Industria bankare në Kosovës ka treguar stabilitet dhe qëndrueshmëri në vazhdimësi që nga paslufta dhe deri në vitet e fundit, duke ofruar siguri si dhe duke treguar besueshmëri tek qytetarët e Republikës së Kosovës. Industria bankare ka shënuar vlera pozitive të rritjes pothuajse në të gjithë indikatorët kryesorë të saj, çka tregon për një treg të shëndoshë të kësaj industrie.

### Struktura e asetëve

Tabela 3 tregon të dhëna mbi gjithsej asetet e industrisë bankare si dhe të strukturës së kësaj industrie.

STRUKTURA E ASETËVE TË INDUSTRIËSË BANKARE (milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Jan-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	447.1	491.2	496.6
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	390.7	316.0	334.0
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8	473.5	445.4
Kreditë dhe lizingu	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.4	2,019.4	2,005.7
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7	57.3	58.1
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	27.9	29.8	31.7
<b>Gjithsej Asete</b>	<b>2,455.1</b>	<b>2,649.7</b>	<b>2,829.3</b>	<b>3,059.3</b>	<b>3,185.6</b>	<b>3,387.3</b>	<b>3,371.4</b>

Tab. 3 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (mars 2016)

Në kuadër të gjithsej asetëve të industrisë bankare, pjesën kryesore e përbëjnë kreditë dhe lizingu me gjithsej 59.5% (Janar 2016), pastaj paraja e gatshme me 14.7%, letrat me vlerë 13.2% dhe kështu me radhë.




Fig. 3 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)



Trendi i rritjes të gjithsej asetëve dhe kredive mund të vërehet edhe nga figura 3 e paraqitur. Në fund të vitit 2015, gjithsej asetet janë rritur për 6.3% në raport me vitin 2014, përderisa kreditë dhe lizingu është rritur për 7.2% gjatë të njëjtës periudhë. Të dhënat e paraqitura për muajin janar 2016 nuk mund të krahasohen me periudhat paraprake, meqenëse nuk paraqesin vitin e plotë, mirëpo janë pasqyruar vetëm për qëllime informacioni.

## Struktura e detyrimeve

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIJË BANKARE (milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Jan-16
Bilanci nga bankat tjera	70.7	40.0	6.0	16.5	31.6	43.4	46.0
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,701.4	2,670.6
Huatë tjera	23.4	30.4	18.9	13.4	14.1	17.6	17.6
Provizionet e shlyera	0.1	0.2	1.7	2.0	2.9	3.1	2.9
Detyrimet tjera	160.1	191.3	221.4	244.1	229.2	191.2	198.8
Borxhi i ndërvarur	33.5	31.0	31.0	56.3	47.3	36.8	36.8
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.5	0.1	-	-	-
Mjetet vetanake	230.4	252.8	270.7	277.8	323.0	393.8	398.7
<b>Gjithsej Detyrime</b>	<b>2,455.1</b>	<b>2,649.7</b>	<b>2,829.3</b>	<b>3,059.3</b>	<b>3,185.6</b>	<b>3,387.3</b>	<b>3,371.3</b>

Tab. 4 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (mars 2016)

Në kuadër të strukturës së detyrimeve nga tabela 3 mund të shihet se depozitat dominojnë pjesën kryesore me gjithsej 79.2% të gjithsej detyrimeve në janar të vitit 2016, përderisa pjesën tjetër e përbëjnë mjetet vetanake me 11.8%, detyrime tjera me 5.9% dhe kështu me radhë.

Tabela 5 tregon mbi raportin ndërmjet depozitave dhe kredive të industrisë bankare. Nga të dhënat e marra për bazë krahasimi, mund të shihet se industria bankare gjithnjë ka mbajtur raportin ndërmjet kredive dhe depozitave në afërsisht 80%, duke qenë kështu likuide gjatë gjithë kohës dhe e gatshme të mbulojë obligimet e saj në çdo kohë.

KREDITË BRUTO NË RAPORT ME DEPOZITAT (milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Jan-16
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,701.4	2,670.6
Kreditë bruto dhe lizingjet	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.4	2,019.4	2,005.7
Raporti	75.3%	80.7%	77.4%	73.7%	74.2%	74.8%	75.1%

Tab. 5 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (mars 2016)

Në figurën 4 gjithashtu mund të vërehet trendi rritës i të dy indikatorëve më kryesorë të industrisë bankare që janë depozitat dhe kreditë. Të dhënat e paraqitura për muajin janar 2016 nuk mund të krahasohen me periudha paraprake, meqenëse nuk paraqesin vitin e plotë, mirëpo janë pasqyruar vetëm për qëllime informacioni.




Fig. 4 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese (mars 2016)

Rritja e depozitave dhe kredive është në raport afërsisht të ngjashëm me njëra tjetrën, duke siguruar që kreditë e lëshuara nga kjo industri të mos tejkalojnë asnjëherë depozitat e qytetarëve që i kanë deponuar.

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (milion euro)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	22.0	113.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	55.0	99.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	54.5	108.8	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	68.8	102.6	1,217.4
2014	49.8	19.7	153.0	20.3	107.0	674.5	51.4	18.1	60.6	102.0	1,256.4
2015	59.9	19.2	164.1	17.8	99.5	683.0	50.7	21.3	94.0	123.8	1,333.4
16-Jan	53.8	18.9	167.8	17.1	99.1	673.7	50.2	22.2	92.1	114.2	1,308.9

Tab. 6 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik (mars 2016)

Në kuadër të strukturës së kredive të lëshuara për sektorë të ekonomisë, dominojnë kreditë e lëshuara për tregti të cilat në janar të vitit 2016 përbënin 51.5% të gjithsej kredive sipas aktivitetit ekonomik, pastaj prodhimi me 12.8%, shërbimet tjera me 8.7% dhe kështu me radhë. Në fillim të vitit 2016 vërehet një trend i zvogëlimit të kreditimit, mirëpo kjo nuk mund të krahasohet me vitet paraprake dhe nuk paraqet një vit të plotë kalendarik.

## Të hyrat dhe shpenzimet

Industria bankare në Kosovë gjithashtu ka shënuar vazhdimisht vlera pozitive të të hyrave në raport me shpenzimet. Në tabelën 7 dhe 8 mund të shohim këtë raport të këtyre dy indikatorëve.

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)								
Periodha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimi	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
2010	169.6	2.7	3.1	0.4	37.5	3.9	.	217.2
2011	186.3	4.1	4.2	0.5	41.7	3.3	.	240.1
2012	194.9	2.0	3.0	0.6	44.2	2.4	.	247.0
2013	192.5	1.4	2.3	2.0	45.6	3.9	1.2	249.0
2014	190.7	1.1	2.9	2.5	44.6	3.1	0.5	245.3
2015	180.4	0.5	4.4	0.7	47.1	4.0	1.1	238.2

Tab. 7 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (mars 2016)

Në tabelën 8 mund të shohim se të hyrat nëpër vite të marra për krahasim kanë qenë afërsisht të njëjta, përderisa shpenzimet nëpër vite kanë shënuar ulje sidomos në tri vitet e fundit, çka ka bërë që edhe fitimi i realizuar për këtë sektor të rritet.

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)										
Periodha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp. të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp. personelit	Shp. të përgjithshme	Shp. tjera nga jo-interesi		
2010	49.4	4.8	1.1	7.7	28.3	37.8	37.6	12.6	5.5	184.8
2011	51.3	5.6	1.5	8.5	34.8	40.7	33.5	22.9	5.3	204.1
2012	57.6	3.2	2.3	8.7	50.3	42.3	35.5	24.5	4.0	228.6
2013	58.0	2.6	3.2	9.4	46.1	42.3	35.6	22.5	3.2	223.0
2014	36.4	3.3	4.5	11.1	20.5	42.7	35.1	24.4	6.8	184.8
2015	16.7	3.8	2.1	12.0	-8.4	44.0	35.7	27.8	9.7	143.5

Tab. 8 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (mars 2016)

Në figurën 5 janë të paraqitura trendet e të hyrave dhe shpenzimeve si dhe ndryshimin ndërmjet këtyre dy indikatorëve, përkatësisht fitimin e realizuar nga industria bankare.




Fig. 5 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)

Industria bankare në fund të vitit 2015 shënoj një fitim në vlerë prej 94.7 milionë euro, që paraqet një rritje prej 56.5% më shumë se sa në vitin 2014.

Nje foto ilustrative

Trendi i ngjashëm pozitiv ka vazhduar edhe gjatë vitit 2016, me ç'rast në janar janë shënuar gjithsej 19.5 milionë euro të hyra, përderisa shpenzime gjithsej 14.1 milionë euro që paraqet një fitim neto prej 5.4 milionë euro.




Fig. 6 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese (shkurt 2016)

## Normat efektive të interesit

Industria bankare gjatë dy viteve të fundit ka arritur që të zvogëloj ndjeshëm normën efektive të interesit në kredi, çka nënkupton se kostoja e kredisë për qytetarët e Kosovës është zvogëluar. Me uljen e normës efektive të interesit në kredi, pavarësisht rënies së normës efektive të interesit në depozita, ka bërë që të zvogëlohet edhe diferenca në përqindje ndërmjet këtyre dy normave.




Fig. 7 | Burimi: BQK – Normat efektive të interesit në kredi dhe depozita të reja (mars 2016)

Siç shihet edhe nga trendi i paraqitur në figurën 7, që nga viti 2012 të dy normat e interesit, duke përfshirë edhe margjinën ndërmjet normës së interesit në kredi dhe depozita kanë shënuar ulje të ndjeshme.

Është e rëndësishme të potencohet se norma efektive e interesit në kredi ka arritur vlerën më të ultë që ka shënuar ndonjëherë industria bankare në Kosovë, që në fakt paraqet një sukses shumë të rëndësishëm për këtë industri.

## Referencat

---

Banka Botërore, Kreditë bankare jo-performuese në raport me bruto totalin e kredive, mars 2016, <http://data.worldbank.org/indicator/FB.AST.NPER.ZS>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, mars 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i informatave mujore të sistemit financiar, dhjetor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=98>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti vjetor 2013 dhe 2014, <http://bqk-kos.org/?id=102>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në depozita të reja, mars 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në kredi të reja, mars 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese, mars 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

**PJESA III**

**LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE QË SHËNUAN**

**MUAJIN SHKURT**



## SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS DHE BANKA QËNDRORE E KOSOVES DISKUTUAN MBI PROGRESIN E ARRITUR NË IMPLEMENTIMIN E STANDARDEVE TË BAZEL-IT



Më 2 shkurt, 2016 në vazhden e takimeve në kuadër të projektit për implementimin e standardeve të Bazel-it u mbajt takimi konsultativ mes Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Bankës Qëndrore të Kosovës (BQK). Në këtë takim sektori bankar u përfaqësua nga drejtori ekzekutiv z. Petrit Balija dhe kryetari i Komitetit të Riskut në SHBK z. Gem Maloku, ndërsa nga ana e BQK-së prezent në takim ishin z. Ralf Raab këshilltar i lartë pranë departamentit të Mbikëqyrjes Bankare në BQK dhe z. Amir Zylfiu nga mbikëqyrja bankare në BQK.

Në takim në mes tjerash u diskutua për progresin e arritur gjatë vitit 2015 dhe për punën që pritet të bëhet gjatë vitit 2016 në lidhje me implementimin e standardeve të Bazel-it. Z. Balija konstatoi se është arritur progres i mirë në një periudhë relativisht të shkurtër falë angazhimit të z. Raab dhe ekipit të tij nga BQK si dhe ekspertëve të sektorit bankar të cilët kanë punuar ngusht në një grup punues për realizimin e këtyre objektivave, por se mbetet ende shumë për të bërë gjatë vitit në vijim. Ndërkaq z. Raab ishte mirënjohës për bashkëpunimin me Shoqatën e Bankave të Kosovës në tërë këtë proces në mënyrë që edhe industria bankare në Kosovë të përafrohet me standardet ndërkombëtare financiare si pjesë e planeve integruese gjithëpërfshirëse të vendit.

Ky projekt i BQK-së është duke u mbështetur nga organizata gjermane GIZ. (Shoqata e Bankave të Kosoves, 4 shkurt 2016)

## MINISTRJA E TREGTISË DHE INDUSTRIKË, HYKMETE BAJRAMI, TAKOI SHOQATËN E BANKAVE TË KOSOVËS



Ministrja Hykmete Bajrami priti sot në takim Bordin e Drejtorëve të Shoqatës së Bankave të Kosovës. Ministrja Bajrami në fillim të takimit theksoi se Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është e përkushtuar për bashkëpunim me sektorin bankar në funksion të përmirësimit të klimës së biznesit në vend. Ministrja Bajrami po ashtu me theks të veçantë përmendi nevojën e një komunikimi të drejtëpërdrejt mes MTI-së dhe Shoqatës së Bankave për të gjitha sfidat që dalin gjatë punës në sfera të ndryshme të këtij sektori. Kryetari i Shoqatës së Bankave të Kosovës z. Petrit Balija shprehu gatishmërinë për bashkëpunim dhe ngriti disa çështje lidhur me regjistrin elektronik të pengut. Ai potencoi rëndësinë e madhe që ka për bankat ky regjistër dhe kërkoi që politikën e MTI-së sa i përket këtij regjistri të jenë në përputhje me nevojat e bankave dhe klientëve të tyre. Ministrja premtoi që po punohet që sa më shpejt të zgjidhen të gjitha çështjet për të cilat Shoqata shprehu shqetësim dhe të dyja palët u pajtuan që një bashkëpunim i tillë mes MTI-së dhe Shoqatës së Bankave të vazhdojë në mënyrë që sistemi bankar të funksionojë pa pengesa duke qenë gjithmonë në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve. (Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Shoqata e Bankave të Kosoves, 15 shkurt 2016)

## IFC DHE SHOQATA E BANKAVE PËRFORCOJNË INSTITUCIONET FINANCIARE



IFC-ja, anëtare e Grupit të Bankës Botërore në partneritet me Shoqatën e Bankave të Kosovës do ta mbështesë sistemin vendor të shërbimeve bankare për t'i përforcuar sistemet relevante të menaxhimit të rrezikut, do të asistojë në përmirësimin e menaxhimit të kredive jo-performuese dhe në përmirësimin e shërbimeve bankare për sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) përmes trajnimeve dhe punëtorive. Ceremonia e sotme e nënshkrimit bëhet për ta festuar fillimin e këtij bashkëpunimi. “Angazhimi i IFC-së në sektorin financiar të Kosovës dhe të rajonit më të gjerë të Ballkanit mbetet prioritet strategjik dhe përfshinë një kombinim të investimeve dhe shërbimeve këshilluese,” tha Thomas Lubeck, Menaxher Rajonal i IFC-së për Ballkanin Perëndimor. “Nën këtë bashkëpunim ne do të sjellim njohuri globale dhe do të ndërtojmë mbi përvojën vendore të partnerit tonë Shoqatës së Bankave të Kosovës për t'i dhënë këshillat e synuara.” Deri në qershor 2017, IFC-ja dhe Shoqata e Bankave të Kosovës do t'i mbajnë një seri të trajnimeve dhe punëtorive që mbulojnë menaxhimin e rrezikut, rrezikun operacional, likuiditetin, zgjidhjen për asetet e konfiskuara për shkak të kredive të papaguara dhe shërbimet bankare për segmentit NVM. “Shoqata e Bankave të Kosovës ka pasur një bashkëpunim të

mirë me IFC-në në disa fusha të ndryshme, duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të sektorit bankar. Kjo marrëveshje e bashkëpunimit do t'i mundësojë sektorit bankar që të ketë qasje në një numër të trajnimeve në disa nga temat më të rëndësishme për këtë sektor“ tha z. Petrit Balija, drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Bankave të Kosovës.

Përveç kësaj serie të trajnimeve veçanërisht të profilizuara, në fillim të marsit, IFC-ja planifikon që ta organizojë Konferencën për Inovacionet në shërbimet bankare për segmentin NVM në Beograd, Serbi, duke mobilizuar përfaqësuesit e sektorit financiar nga mbarë Ballkani.

Kjo do të jetë një mundësi për t'i shfaqur produktet më të reja të shërbimeve bankare dhe praktikat më të mira për huadhënie segmentit NVM, duke theksuar një qasje gjithëpërfshirëse që mbulon të gjitha zonat kyçe, nga modeli i biznesit të arsyeshëm dhe dizajni i duhur i produktit e deri te kanalet e gjera të shitjes dhe menaxhimi i arsyeshëm i rrezikut. Puna rajonale e IFC-së për t'i përforcuar sistemet financiare në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore mbështetet me fondet nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO). (Agjencia e Lajmeve Ekonomia, Telegrafi, 25 shkurt 2016)

## BANKA QENDRORE E KOSOVËS SHTON BASHKËPUNIMIN ME BANKËN E SHQIPËRISË



Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës Bedri Hamza ka pritur në një takim Gent Sejko Guvernator i Bankës së Shqipërisë. Guvernatori ka falënderuar Sejko për vizitën dhe fillimisht u ndal për një shpjegim të detajuar për zhvillimet ekonomike e financiare në Kosovë, me theks të veçantë për industrinë bankare, industrinë e sigurimeve dhe për sfidat nëpër të cilat ka kaluar ky sistem. Gjithnjë sipas të dhënave dhe treguesve të zhvillimeve aktuale kemi të bëjmë me një sistem të shëndoshë dhe likuid, ka zhvillime pozitive në vazhdimësi në gjithë sektorët, u shpreh Guvernatori Hamza. Gjatë bashkëbisedimit të dy guvernatorët kanë shkëmbyer informacione lidhur me zhvillimet në përgjithësi, si dhe për sfidat në të cilat po kalojnë sektorët financiarë të të dyja vendeve. (Zëri, Agjencia e Lajmeve Ekonomia, 25 shkurt 2016)

## QEVERIA E KOSOVËS MBAJTI ANKANDIN E BONOVE TË THESARIT

Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbajtur të martën Ankandin e Bonove të Thesarit KV003-16, ku u ofertuan Bono Thesari 12-mujore në vlerë nominale prej 25 milionë euro. Shuma e ofertuar do të shërbejë për ri-financimin e instrumentit të emetuar në shkurt 2015.

Në ankandin e Bonove të Thesarit, tregu ka shfaqur kërkesë për blerje në vlerë 72.2 milionë euro. Kjo është shuma më e lartë që ndonjëherë ka ardhur si kërkesë

e tregut të Bonove të Thesarit. Blerësit e Bonove të Thesarit sipas kategorive janë Bankat private me 24.75 milionë euro si dhe kompanitë e sigurimeve me 0.25 milion euro dhe si rezultat i normës më të ulët të ri-financimit do të kemi edhe të hyra buxhetore prej 138,036.59 euro. (Telegrafi, 10 shkurt 2016)



## KREDIA E KOSOVËS NË BB, RRETH 85 MILIONË EURO

Ministri i Financave Avdullah Hoti ka deklaruar se deri më tani, shuma totale e kredive të nënshkruara me Bankën Botërore është rreth 85 milionë euro. Sipas tij, projektet duhet të implementohen brenda kornizës së paraparë ligjore, ngase çdo shtyrje paraqet kosto më të lartë të huamarrjes, si dhe efekt buxhetor. Ai këto komente i bëri në një tryezë të diskutimit për Portofolin kreditor me Bankën Botërore, në të cilin morën pjesë përfaqësues të institucioneve vendore, të Bankës Botërore, si dhe koordinatorë të projekteve. (Zëri, 10 shkurt 2016)



# WORLD BANK

## TASK-FORCË PËR TRAJTIMIN E 90 MIJË LËNDËVE




Një trupë prej dhjetëra bashkëpunëtorësh e këshilltarësh ligjorë është paraparë të krijohet me synimin për të zgjidhur rreth 90 mijë lëndë për kundërvajtje, që gjykatat nuk u kanë dhënë epilog deri tash, shkruan sot Koha Ditore. Ekzekutivi synon që zgjidhja e tyre të bëhet brenda katër vjetësh. Kjo “reformë” në drejtësi është sponsorizuar nga Ministria e Financave dhe është miratuar së fundmi nga kabineti qeveritar. Gati 12 milionë euro është kostoja e saj. Pos krijimit të Taks-forcës, parashihet të ndërmerren edhe një varg veprimesh të tjera. (Koha Ditore, 3 shkurt 2016)



# PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“Periodiku Bankar” është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë. Çdo publikim mujor trajton çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore ka sektorin bankar në Kosovë.  
[www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com).





# Qendra për Trajnime Bankare

## TRAJNIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2016:

Certifikimi Ndërkombëtar EFCB

Bazat e Pajtueshmërisë

Lidershipi dhe formimi i Ekipeve

Menaxhimi i Riskut Operacional

Menaxhimi i Porfolios së Riskut Kreditor

IFRS

Nga Zyrtar i TI në Auditor të TI

Mbikëqyrja e Stafit

Mirësjellja në Biznes



Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për Trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

038 246 171

[kbtraining@bankassoc-kos.com](mailto:kbtraining@bankassoc-kos.com)



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Design: Mithat Sejdiu